



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2299/3Prot.

Pukë, më 07.01 .2025

PROCESVERBAL I MBLEDHJES Së KËSHILLIT BASHKIAK PUKË
Date 27 .12 .2024

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe ne zbatim të vendimit të kryesise së keshillit nr. 4 date 19. 11 .2024, mbledhja e radhes e keshillit te Bashkise Puke u zhvillua më datën 27 . 12 .2024 ,ora 11-⁰⁰ tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 03.12.2024
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Tetor 2024**.
3. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Nentor 2024**.
4. Projekt-vendim : " Per shtyrjen e afatit te planit social te Bashkise Puke 2021-2023 deri ne miratimin e planit te ri social 2025-2028"
5. Projekt-vendim " Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetin vjetor për vitin 2025"
6. Projekt –Vendim : " Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKB nr. 56 date 30.12.2022 " Per miratimin e paketes fiskale 2023"(i ndryshuar)
7. Projekt - vendim " Për një shtesë në VKB nr 6 date datë 09. 02.2024 " Për miratimin e dhënies në përdorim nga fondi pyjor të një sipërfaqe pyjore publike prej 6.65 Ha në ekonominë pyjore Kryezi –Bicaj për ndërtim kanali dhe shtrirje tubacioni uji nga subjekti "Uji Puka"
- 8 .Projekt Vendim " Për dhënie në përdorim me afat 10 vjet, sipërfaqe pyjore prej 11 Ha për qellime pushimi, argëtimi, shëndetësore, turistike, sportive dhe kulturore" në parcelën, nr. 93/a dhe 101/a të ekonomisë pyjore Krrab-Bushat"

9. Projekt-Vendim “ Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave profesionale për vitin shkollor 2024-2025”

10. Projekt-Vendim “ Për trajtimin me bursë të nxënësve të akomoduar në konviktin “Ali Bytyçi” për vitin shkollor 2024-2025”

11. Projekt-Vendim “ Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë”

12. Projekt-Vendim “ Për miratimin e rregullores së komisionit këshillimor “ Për titujt vendor të nderit , kriteret dhe procedurën e dhenies së tyre , si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve , institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”

13. Projekt-vendime : Për vleresim me tituj nderi për personat si me poshtë:

Zj. Kristina Marku, z. Ekrem Bardha (shtetas shqiptaro-amerikan), z. Marash Niculaj(shtetas shqiptaro-amerikan), zj. Anjeza (Ndoj) Gjonaj, Z. Daniel Carmody(shtetas amerikan), Z. Gjovalin Lumaj(shtetas shqiptaro-amerikan) dhe z. Vehbi Bajrami .

14. Të tjera.

Ne mbledhje moren pjese: Kryetari i Bashkise , z. Rrok Dodaj, zv/kryetari z. Ferit Ringaj, drejtorja e Finaces zj.Fiqirete Latifi, drejtori i burimeve njerezore z. Sokol Gjoni, Shefja e sektorit te tatim-taksave zj. Gjyste Marku, shefi i sektorit te pyjeve z. Edmond Prendi, shefja e sektorit te ndihmes ekonomike zj. Lavdie Terbuni, drejtori i sherbimeve z. Demir Syla, drejtorja e menaxhimit te territorit zj. Lindita Hyseni etj.

Mbledhja filloi ne oren 11:00 siç ishte njoftuar. Jane prezent ne mbledhje 12 keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes.

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit te Bashkise z. Gjon Gjoka., i cili prezantoi para keshillit kërkesën nr. 2325 date 26.12.2024 për pranimin e projekt-vendimit nr. 16 date 24.12.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Pukë, njësive administrative, institucioneve të vartësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2025”, po keshtu dhe projekt-vendimi nga drejtoria e finances “Per miratimin e kalendarit te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”, te dy keto projektvendime jane kerkuar te shtohen në rendim e ditës:

Pyetje: D. Asani : Pse nuk jane paraqitur ne kohe? Dy pikat shtese t'i shtyjme per mbledhjen e ardhshme. Si ka mundesi qe nuk ju bene pershtypje, qe nje projekt te vije ne minuten e fundit. Eshte gabim sjellja ne minuten e fundit, pasi ne te dy propozimet ke te beshe me financa dhe duhet kohe reflektimi.

Sqaron : Sokol Gjoni: Me vendimin e kryetarit te bashkise eshte miratuar struktura . Ka nje ndryshim te vogel dhe eshte e domosdoshme te miratohet ne keshill ky projektvendim per nivelin e pagave. Niveli i pagave eshte miratuar nga keshilli ne mbledhjen e muajit Tetor 2024 . Ketu jane propozuar disa shtesa, nuk ka shkurtime te punonjesve, megjithese numri i punonjesve eshte 357 nga 370 qe ishte vitin e kaluar.

D. Asani : Pse nuk i keni hedhe poshte vete?

Gj. Gjoka: Nuk jam askushi , qe t'i hedhi poshte vete. Keshilli, nese do e hedh poshte me vote, pra nuk e miraton, ose ne te kundert e miraton .

N. Lalaj: Nuk ka nevojte per lemoshe. Eshte sjell per shtese ta hedhim ne vote .Realishte nivelin e pagave e kemi miratuar ne Tetor.

Gj. Gjoka : e hedhim ne vote rendin e dites me shtesat:

U hodh ne votim rendi i dites me dy projektvendimet shtese. **Nuk u miratua pasi mori vetem 6 vota pro, 4 vota kunder dhe 2 vota abstenim.**

Ne vijim u hodh ne votim rendi i dites **pa shtesa dhe u miratua me 12 vota pro, 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 03.12.2024: Ne vijim u hodh ne votim procesverbali i mbledhjes se keshillit te dates 03.12.2024 dhe **u miratua me 12 vota pro. 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.**

2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Tetor 2024**. Me pas u diskutua dhe u hodh ne votim projekt- vendimi per miratimin e ndihmes ekonomike , duke perdorur deri ne 6% te buxhetit.

U miratua ndihma per muajin Tetor 2024, me 12 vota pro. 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.

3. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Nentor 2024**. Me pas u diskutua dhe u hodh ne votim projekt- vendimi per miratimin e ndihmes ekonomike , duke perdorur deri ne 6% te buxhetit.

U miratua ndihma per muajin Nentor 2024, me 12 vota pro. 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.

4 Projekt-vendim : “ Per shtyrje te afatit te planit social te Bashkise Puke 2021-2023 deri ne miratimin e planit te ri social 2025-2028”

Sqaron : Lavdie Terbuni: Ne vitin 2021 eshte miratuar nje plan social i Bashkise , qe shtrinte efektet deri ne vitin 2023. Ne vijim eshte proceduar me zgjatje te afatit te planit dhe po punohet per hartimin dhe miratimin e planit social 2025-2028.

Me pas u hodh ne votim projekt-vendimi : “ Per shtyrje te afatit te planit social te Bashkise Puke 2021-2023 deri ne miratimin e planit te ri social 2025-2028” U miratua shtyrja e afatit te planit social te Bashkise Puke 2021-2023 deri ne miratimin e planit te ri social 2025-2028 , me **12 vota pro. 0 vota kunder, 0 vota abstenim.**

5. Projekt-vendim “ Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxheti vjetor për vitin 2025”

Sqaron : Fiqirete Latifi(drejtore e finances) Eshte faza fillestare e miratimit te buxhetit afatmesem.. Sivjet eshte realizuar ne system nga MF. Detajet jane sipas tabelave te paraqitura ne projektbuxhet vijon sqarimin e detajeve te prezantuara ne permbajtjen e seciles table bashkelidhur projektvendimit dhe relacionit perkates.

Pyetje / diskutime: D.Asani : Te zjarrefikset ska nevoje per vinç, po policia bashkiake çfare ka te parashikuar ne buxhet? B. Aliaj: A nuk mund te blihet nje zjarrefikse?

F. Latifi: Per policine bashkiake ka te parashikuara vetem pagat. Me keto leke qe i perkasin buxhetit sektorial per MNZSH nuk mund te blihet nje zjarrefikse , e cila kushton shume me teper.

Rr. Dodaj: Bashkia Puke ka nevoje per mjete. Zjarrefikset qe kane ardhur falas jane terhequr nga paraardhesit tane dhe mjetet e tjera i kane marre.Na duhet nje mjet me vinç per repartin zjarrefikes. Kemi menduar ta blejme nje zjarrefikse duke bashkepunuar me organizma te ndryshem.psh, Bashkia Fushe-Arres perfitoi nje fadrome me bashkefinancim.Ne na intereson shume ky mjet dhe do te kerkojme bashkefinancues dhe ta blejme te ri si mjet.

B. Aliaj: A e kane kerkuar reparti i zjarrefikseve? A do te jete ne sherbim te tyre?

E. Sulejmani: Ndriçimi i lagjes Kukaj a eshte parashikuar? Grandi per investimet a ka ardh i veçante?

F. Latifi: Grandi ka ardh komplet pa ndarje.

D. Asani : Sa eshte fondi i trasheguar sektorial i zjarrefikseve? Eshte 4milion leke dhe ke parashiku blerje vinç , po keshtu dhe 3.5 milion leke per blerje kamionçine. Te shihet edhe nje here çfare ju duhet kamionçina?

F. Latifi: Eshte parashikuar te blihet me te ardhurat e vete Bashkise.

D. Asani : Me te dyja buxhetet bashke mund te blihet nje zjarrefikse(pra 3.5 milion leke t'i kalohen zjarrefikses.)

N. Lalaj: Mjetet jane shume te domosdoshme dhe nuk mendoj se duhet me i diskutu.Mjetet duhet te blihen sa me shpejte. Mjete dhurate qe jane marre nga paraardhesit te kthehen sa me shpejte ne Bashki.

Rr. Dodaj: Kemi bere projekte dhe kemi te konfirmuar per investime per vitin 2025:

-Tregun e qytetit.

Projektet i fitojme ne bashkepunim me Qeverine dhe me sigurimin e te ardhurave.

-Veshja e pallateve me system kapote.

-Dy hyrjet e qytetit (sistemim asfaltim, trotuare dy segmentet rrugore ne dy anet e qytetit)

- Do te bejme ndriëimet ne disa fshatra dhe ka mbaruar procedura e dy liçeneve, qe do te lidhen bashke dhe se shpejti do te behet prezantimi publik i projektit.

- ka perfunduar ujesjellesi i Gjegjanit dhe qendra shendetesore dhe nje ambulance e blere nga Bashkia me bashkefinancim.

- Kena miratuar sistemim-rrethimin e varrezave te qytetit.

D. Asani: Te falenderoj Kryetar.Une te tregoj problematikat. Per sa pallate ke marre investim? Edhe sa te tjere jane te planifikuar?

Rr. Dodaj: Tani jane 5 pallate dhe do te behen te gjitha pallatet e qytetit.

D. Asani: Kam nje vit qe kerkoj projekte per njesine administrative Qelez. Nuk ka investime per njesite vendore.

Rr. Dodaj: Kemi 4 ura qe i kemi perfituar nga Ministria e Mbrojtjes.

Ne perfundim projekt-vendimi per buxhetin u hodh ne votim: **U miratua me 12 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.**

6. Projekt –Vendim : “ Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKB nr. 56 date 30.12.2022 “ Per miratimin e paketes fiskale 2023”(i ndryshuar)

Sqaron : Gjyste Marku(shefe e sektorit te tatim –taksave) Projekti nuk ka ndryshime , pervec se tarifa e salles se vogel , qe eshte bere 10 000 leke , nga 5000 leke qe ishte.

Pyetje / Diskutime : B. Aliaj: Mendoj se vlera e tarifes se salles se vogel te jete 5000 leke.

Rr. Dodaj: Edhe me 10000 leke eshte falas , sepse ka shume konsum, demtime etj.

U hodh ne votim dhe u **miratua me 9 vota pro. 2 Vota kunder dhe 1 vota abstenim**

Keshilltaret qe votuan kunder:

Shpjegim vote : B. Aliaj, D. Asani: Nuk jane dakord qe tarifa e salles se vogel te jete 10.000 leke, por 5000 leke.

7. Projekt - vendim “ Për një shtesë në VKB nr 6 date datë 09. 02.2024 “ Për miratimin e dhënies në përdorim nga fondi pyjor të një sipërfaqe pyjore publike prej 6.65 Ha në ekonominë pyjore Kryezi –Bicaj për ndërtim kanali dhe shtrirje tubacioni uji nga subjekti “Uji Puka”

Sqaron Edmond Prendi : Eshte projektvendim i prezantuar dhe me pare , por ka patur munges te statusit juridik te prones. Tani mendoj se dosja eshte e kompletuar.

U hodh ne votim dhe **u miratua me 12 vota pro. 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim**

8. Projekt Vendim “ Për dhënie në përdorim me afat 10 vjet, sipërfaqe pyjore prej 11 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, turistike, sportive dhe kulturore” në parcelën, nr. 93/a dhe 101/a të ekonomisë pyjore Krrab-Bushat”

Pyetje : Sa është vlera e dhenies vjetore me qera?

Sqaron Edmond Prendi: Kjo është vlera e qerases fillestare vjetore. Gjate ankandit kjo vlerë mund të rritet.

Hidhet në votë dhe u **miratua me 11 vota pro , 0 vota kunder, dhe 0 vota abstenim** (A. Cenaj është larguar nga mbledhja për arsye personale)

9. Projekt-Vendim “ Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave profesionale për vitin shkollor 2024-2025”

Pyetje : A përfitojnë burse të gjithë nxënësit?

Sqaron : Sokol Gjoni (drejtori i burimeve njerëzore) : Janë përfshirë të gjithë nxënësit e shkollave profesionale dhe përfitojnë burse.

U hodh në votim dhe u miratua me 11 pro, 0 vota kunder , 0 vota abstenim.

10. Projekt-Vendim “ Për trajtimin me bursë të nxënësve të akomoduar në konviktin “Ali Bytyçi” për vitin shkollor 2024-2025”

Pyetje: -----

Sqaron : Sokol Gjoni (drejtori i burimeve njerëzore) : Janë të përfshirë të gjithë nxënësit , që vijojnë studimet në të dy shkollat e qytetit të Pukës (gjimnazi dhe shkolla 9-vjeçare) që janë të akomoduar në konviktin ‘‘Ali Bytyçi’ Puke.

U hodh në votim dhe u miratua me 11 vota pro, 0 vota kunder, 11 vota abstenim .

11. Projekt-Vendim “ Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë”

Pyetje : D. Asani: Po këshilli a është pjesë e këtij komisioni?

Sqaron : Sokol Gjoni (drejtori i burimeve njerezore) : Ligji 94/2022 detyron qe te ngrihet nje komision keshillimor i perbere nga 3 persona nga administra dhe 2 personalitete te Bashkise. Ndersa keshilli ka nje komision te perhershem per kete qellim.

D. Asani: Eshte detyrim ligjor te ngrihet ky komision por eshte nje komision i anesuar. A ka pagese ky komision? Mendoj te pasurohet dhe te parashikohet pagese per kete komision.

Gj. Gjoka: Nuk na perket ne por duhet te behet degjese publike.

N. Lalaj : Duhet me i pa njerezit sipas njohurive , qe kane dhe jo me syrin partiak. Ne kemi te drejte t'i kthejme propozimet e ketij komisioni.

Hidhet ne votim dhe u **miratua me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim .**

12. Projekt-Vendim “ Për miratimin e rregullores së komisionit këshillimor “ Për titujt vendor të nderit , kriteret dhe procedurën e dhenies së tyre , si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve , institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”

Sqaron : Sokol Gjoni (drejtori i burimeve njerezore) : Qe komisioni te funksionoj ne rregull , duhet te kete nje rregullore, e cila parashikon te gjitha veprimtarine e komisionit. Ne rregullore jane parapare dhe disa vleresime qe bene kryetari i bashkise.

Diskutime : Gj. Gjoka : Mendoj se do te ishte mire qe kjo rregullore paraprakisht te kalonte ne degjese publike.

Hidhet ne votim dhe u **miratua me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim .**

13. Projekt-vendime : Për vleresim me tituj nderi për personat si me poshtë:

Zj. Kristina Marku, z. Ekrem Bardha (shtetas shqiptaro-amerikan), z. Marash Nikulaj(shtetas shqiptaro-amerikan), zj. Anjeza (Ndoj) Gjonaj, Z. Daniel Carmody(shtetas amerikan), Z. Gjovalin Lumaj(shtetas shqiptaro-amerikan) dhe z. Vehbi Bajrami

Sqaron : Sokol Gjoni (drejtori i burimeve njerezore) : Propozimet kane ardhur nga dy institucione qe funksionojne ne Amerike. Jane individe te spikatur qe kane ndihmuar Bashkine Puke dhe banoret e saj.

Rr. Dodaj: Koordinator Fran Gjoka ka bere propozime per vleresim me tituj nderi. Jane personazhe qe kane ndihmuar Puken permes Fran Gjokes.

Per te gjitha rastet e paraqitura per vleresim miratohen ne grup per 7 peronalitete.

Hidhet ne votim dhe u **miratua me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim .**

Hidhet ne votim dhe nuk / u miratua me 3 vota pro, 2 vota kunder, 2 vota abstenim.


Keshilltaret qe votuan kunder:

Shpjegimi i votes kunder:

ALFONS GJERGJAJ



Besmiria Hoxhaj




Aleksander Firodeni



Alban Heshi

Menan Kuci

Mohar Wolaj



Shpresa Pemaj



Georgi Gsoka



sekretari i keshillit

Hazbi Terboris